



Hapet thirrja për mobilitete midis Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Universitetit të Tuscias, Itali, për aplikime për bashkëpunëtorët e kërkimit postdoctoral, për kryerjen e kërkimeve në Universitetin e Tuscias.

Në kuadër të Marrëveshjes bilaterale, midis Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Universitetit të Tuscias, Itali, është hapur thirrja për aplikime për bashkëpunëtorët e kërkimit postdoktoral për kryerjen e kërkimeve në Universitetin e Tuscias.

Universiteti i Tuscias, në kuadër të Programit “SeedTalent” @ UNITUS Grants, i cili siguron financim për bashkëpunëtorët e kërkimit postdoktoral, u drejtohet kërkuesve të talentuar për të thelluar ekspertizën e tyre, për të fituar aftësi të reja dhe për të mbështetur zhvillimin e një projekti kërkimor në cilindo nga Departamentet ose Qendrat Kërkimore në UNITUS.

Studiuesit kanë mundësinë të aplikojnë për një bursë 1+1 në fushat përkatëse kërkimore. Kandidatët që përfundojnë me sukses vitin e parë të kërkimit në UNITUS do të kenë mundësinë për një vit shtesë, në varësi të kushteve të përcaktuara nga UNITUS.

Aplikantët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë formularin e aplikimit online dhe të gjithë materialet e kërkuara të pranimit që janë specifikuar në thirrjen për aplikime deri më 04 Tetor 2021, në orën 11:59 PM (CEST).

Informacionin në lidhje me dokumentacionin dhe afatet kohore e gjeni në link-et e mëposhtëme.

[the online application form and all required admission materials](#)

[call for applications](#)

Për më shumë informacion mund të kontaktoni: Znj. Sonia Castellucci, email: ricerca@unitus.it.

Afati i aplikimit është 04 tetor 2021.